



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:071214

Datë: 12.06.2019

Numri i dokumentit: 00353660

P.nr.914/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Iirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2-1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP .nr.1847/18 të datës 24.12.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **06.06.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Nazmi Krasniqi si dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli ,ndërsa përpilojë me dt. 10.06.2019 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F. B.**, nga Prizreni , Rr.”A. H. “ nr... , data e lindjes ... ,i biri i S. dhe i nënës M. e gjinisë T., ka te kryer shkollën e mesme, rrobaqepës , i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar ,shtetas i R. Kosovës ,i pa martuar, me ID ...

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

-pasi me pare është furnizuar pa autorizimi në kundërshtim me nenin 9 par 9.1 te Ligit për barna narkotike , substanca psikotrope dhe prekusore nr. 02/L-128,me materie narkotike te llojit marihuanë , me dt. 07.12.2018 rreth orës 20.50 min., gjatë një kontrolli nga ana e zyrtareve policor ne Rr .” . . . ” në Gjakovë , pasi ndalojnë veturën e tipit “...” ,ngjyre e zezë, me tar .regj.,në të cilën pasagjer ishte i pandehuri , pas kontrollit tek i pandehuri eshë gjetur një qese najloni e tejdukshme mbushur me substancë narkotike në formë bari ngjyrë e gjelbër e dyshuar si substancë narkotikë marihuanë ,me peshë rreth 0.5gr.,e cila materie është sekuestruar nga zyrtarët policor .

-me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2-1 të KPRK-ës,

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,49,50,51, 73 ,nenit 275/2-1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHTË

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4 (katër) muajve** , i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1(një) viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale,

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30,00 €**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi Aktgjykimi të marrë formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Mbikëqyrjen e periudhës verifikuese të dënimit me kusht do ta bene Shërbimi Sprovues i Kosovës Dega në Prizren.

Gjykata bazuar në nenin 275 par.3 të KPRK-ës lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.7, të akuzuarit ia shqipton masën e :

MARRJA E SENDEVE

Konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuan ngjyrë e gjelbër, me peshë 0.5 gr, që është objekt i kësaj veprë penale e sekuestruar me dt. 07.12.2018.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1847/18 të datës 24.12.2018, ka akuzuar të akuzuarin F.B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2-1 të KPRK-ës.

Gjatë shqyrtimit fillestar gjyqësor të mbajtur me dt.06.06.2019, prokurori i shtetit N.K., bene leximin e aktakuzës PP.nr. 1847/18 të dt.24.12.2018 deklaroi mbetem në tërësi pranë aktakuzës, por sa i përket të dhënave personale për të akuzuarin e beje përmirësimin e të dhënave si në procesverbal të këtij shqyrtimi gjyqësor.

I akuzuari F.B., lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet me qene se nuk jam konsumues i rregullt, andaj i propozoi gjykatës që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë në çdo fazë të procedurës, premtimin e shprehur në gjykatë se me nuk do të përsëris vepra penale të natyrës së njëjtë apo të natyrës së ngjashme, gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se është hera e parë që kam rënë nën ndesh me ligjin, të më shqiptoj një dënim me të butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Prokurori i shtetit N.K., deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu i akuzuari F.B. pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorin juridike të pranimin të fajësisë, dhe se aktakuza ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, po ashtu konform nenit 275/3 të KPRK-ës kërkoj të përcaktohet edhe dënimi plotësues, të konfiskohet substanca narkotike e sekuestruar.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari F. B. : pasi me parë është furnizuar pa autorizim në kundërshtim me nenin 9 par 9.1 të Ligjit për barna narkotike, substanca psikotrope dhe prekusore nr. 02/L-128, me materie narkotike të llojit marihuanë, me dt. 07.12.2018 rreth orës 20.50 min., gjatë një kontrolli nga ana e zyrtareve policor në Rr. "T." në Gjakovë, pasi ndalojnë veturën e tipit "...", ngjyre e zezë, me tar .regj. ... , në të cilën pasagjer ishte i pandehuri, pas kontrollit tek i pandehuri është gjetur një qese najloni e tejdukshme mbushur me substancë narkotike në formë bari ngjyrë e gjelbër e dyshuar si substancë narkotike marihuanë, me peshë rreth 0.5gr., e cila materie është sekuestruar nga zyrtarët policor.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban propozim akuza, nuk ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPP, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjkata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim , gjendjen e dobët ekonomike të akuzuarit, pendimin e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale si dhe faktin se është hera e parë që ka rëndesh me ligjin, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **4 (katër)** muajve , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale , do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryejnë vepër penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike të llojit kanabis (marihuanë), me peshë prej 0,5 gr, që është objekt i kësaj vepre penale e sekuestruar me dt. 07.12.2018 ,u murr komform nenit 275 par.3 të KPRK-ës lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.7 nenit 69 te KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 € ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së., dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € për kompensimin e Viktimave të Krimin numër 05/036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.914/18 më datë 06.06.2019**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**G j y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate

Numri i lëndës: 2018:071214
Datë: 12.06.2019
Numri i dokumentit: 00353660